



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM
nr. 379 , datë 02.11.2015**

“ Mbi disa rekomandime për projekt/ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit"”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

▪ Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪ Servete	GRUDA	Zv/Kryetar
▪ Koço	BROKA	Anëtar
▪ Iva	ZAJMI	Anëtar
▪ Eduard	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 2.11.2015, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me projekt-ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

Baza ligjore: Neni 24, germa f), neni 69 dhe neni 70 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar)

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të i projekt-ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit",

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, Ministria e Financave ka sjellë për mendim projekt/ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".
2. Nga vlerësimi i projekt/ligjit rezultoi se është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Autoriteti i Konkurrencës lidhur me funksionimin e sistemit Bonus-Malus për individualizimin e primit të riskut, nëpërmjet Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës: nr. 247, dt. 09.10.2012 "Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)"; nr.325 , dt. 30.07.2014 "Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta"; dhe Vendimit nr.324, datë 30.07.2014 "Për vendosjen e kushteve dhe detyrimeve ndaj shoqërive të sigurimit për

rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”.

3. Konkretisht nëpërmjet nenit 8 të projektligjit shtohet një nen i ri, neni 10/1, mbi sitemin Bonus-Malus, i cili përfaqëson një sistem eficient tarifimi, që pasqyron profilin e riskut duke individualizuar tarifat e primeve.
4. Me VKK nr.325, datë, 30.07.2014 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”, pika l.1, i është rekomanduar AMF-së: të bëjë të zbatueshëm parashikimin ligjor për trajtimin e dëmit *nga siguruesi i drejtpërdrejtë* sipas parashikimeve të Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Ky rekomandim nuk është pasqyruar drejtpërdrejtë në projektligj.
5. Bazuar në nenin 11 të Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", pala e dëmtuar ka të drejtë të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim te siguruesi, përgjegjës i pronarit të mjetit, me të cilin është shkaktuar aksidenti. Kërkesa për dëmshpërblim, që lidhet me dëmin e shkaktuar nga përdorimi i një mjeti motorik ndaj një mjeti tjetër motorik, mund të trajtohet nga siguruesi i drejtpërdrejtë i pronarit të mjetit motorik të dëmtuar vetëm në rast se shoqëritë e sigurimit lidhin marrëveshje ndërmjet tyre.
6. Trajtimi në çdo rast i kërkesës për dëmshpërblim nga siguruesi i drejtpërdrejtë, do të rriste konkurrencën midis shoqërive të sigurimit në ofrimin e produktit MTPL, duke konkurruar kështu jo vetëm me çmimin e policës së sigurimit, por edhe me cilësinë e shërbimit, shpejtësinë dhe masën e dëmshpërblimit, mënyrën e vlerësimit të dëmit, etj.
7. Për sa më sipër vlerësojmë se projekt-ligji ka reflektuar pjesërisht rekomandimet e dhëna nga AK.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f), nenin 69, pika 1, dhe nenin 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Ministrisë së Financave, që në projekt-ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", të reflektohen ndryshimet e nevojshme, referuar neneve 11 dhe 12 të Ligjit, me qëllim që në çdo rast palës së dëmtuar t’i mundësohet trajtimi i kërkesës për dëmshpërblim nga siguruesi i drejtpërdrejtë për të mundësuar rritjen e konkurrencës mes shoqërive të sigurimit dhe përmirësimit e cilësisë së shërbimit për të siguruarit.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi Ministrisë së Financiare dhe ndjekjen e zbatimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)
Zv/Kryetar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)
Anëtar

Eduard YPI

(_____)
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R